

VENDIM
Nr.1353, datë 10.10.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS, MBAJTJEN
DHE PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK, SI DHE TË KRITEREVE E TË
PROCEDURAVE TË ZVOGËLIMIT TË SIPËRFAQES E TË VËLLIMIT
TË FONDIT PYJOR¹**

(Ndryshuar me VKM nr. 434 datë 8.06.2016; nr. 591, datë 9.10.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e *Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, fizikë ose juridikë apo *bashkitë*, për pyjet *bashkiake*, e paraqesin kërkesën për heqjen e një sipërfaqeje nga fondi pyjor në *Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit*, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

2. Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban gjenealitetet e kërkuarit dhe të subjektit, që ai përfaqëson, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë, që do të ushtrojë dhe investimet, që do të bëhen.

3. Kërkesa për heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor është e vlefshme vetëm kur bëhet për veprimtaritë e përcaktuara shprehimisht në nenin 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

4. Personat, fizikë ose juridikë apo *bashkitë*, për pyjet *bashkiake*, e paraqesin kërkesën në ministri, vetëm pasi kanë siguruar lejen, licencën ose dokumentin, që miraton ushtrimin e veprimtarisë, të lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj për dhënien e miratimit.

5. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) *Shfuqizuar*;

b) *Shfuqizuar*;

c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si dhe kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit.

e) *Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore, e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.*

6. Ministria mund t'ia kthejë kërkuarit dokumentacionin teknik, të paraqitur, për plotësime e saktësime. Koha për plotësimin e dokumentacionit nuk llogaritet në afatin e përcaktuar për shqyrtimin e kërkesës, i cili është një muaj.

7. *Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki identifikimin e ngastrave e të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga data e marrjes së kërkesës. Ky raport i përçillet ministrisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.*

8. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm:

a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha;

b) ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave;

c) ministria përgatit projektligjin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje e toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha dhe e dërgon atë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, i cili, kur e gjen të rregullt, e përcjell në Kuvend, për miratim.

¹ VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 29 tetor 2008.

VKM nr. 434 datë 8.06.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 14 qershor 2016.

VKM nr. 591, datë 9.10.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 147, datë 16 tetor 2018.

Praktikat e projektvendimit e të projektligjit nënshkruhen nga *Ministri i Turizmit dhe Mjedisit*, dhe nga ministri, që ka miratuar veprimtarinë.

9. Pas miratimit të heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor:

a) drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor bën përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe në vëllim dhe të dhënat i përcjell në ministri;

b) ministria bën përditësimin në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve;

c) zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në kategorinë e re të përdorimit.

10. Sipërfaqja, që hiqet nga fondi pyjor publik, sipas këtij vendimi, kalon në një destinacion tjetër përdorimi, por, në çdo rast, mbetet në pronësi publike.

11. *Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 8, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.*

12. Në rastet e ndërtimit të infrastrukturave lineare, si rrugë, linja të transmetimit ajror apo nëntokësor të energjisë elektrike, të naftës, gazit, telekomunikacionit, si dhe teleferikët, të cilat, në përputhje me projektet e miratuara, kërkojnë një trase të pastruar nga vegjetacioni, me gjerësi më të vogël se 10 m, për efekt kadastral, bëhet vetëm zvogëlim në vëllim, por jo në sipërfaqe.

13. Për shërbimin e ofruar nga ministria, sipas këtij vendimi, kërkuesi paguan një tarifë shërbimi, në vlerën 20 000 lekë, e cila derdhet në llogarinë bankare të ministrisë, në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kjo tarifë është e pakthyeshme edhe nëse kërkesa nuk miratohet.

14. Kur kërkesën për ndryshimin e destinaiconit të një pjese apo të të gjithë pyllit a sipërfaqes pyjore, e bën pronari privat që e ka në pronësi, kërkesa sqaron:

a) sipërfaqen, që do t’i ndryshohet destinacioni;

b) veprimtarinë për çfarë do të përdoret (veprimtarinë që do të ushtrohet apo objektin që do të ndërtohet në të).

15. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Kopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë së pyllit apo sipërfaqes pyjore;

b) Studimin apo projektin e veprimtarisë që do të ushtrohet, apo të veprës që do të ndërtohet;

c) Kopjen e noterizuar të licencës, që ka miratuar veprimtarinë apo ndërtimin e objektit;

ç) Planimetrinë e sipërfaqes, që kërkohet të ndërrojë destinacion, në hartën topografike, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe kufijtë e pyllit apo të sipërfaqes pyjore, që mbetet pas miratimit të kërkesës;

d) Mandatpagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 14 të këtij vendimi.

16. *Kur kërkesa bëhet sipas përvaktimit të pikës 14, ajo shqyrtohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati ajo qubet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.*

17. Ngarkohen *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe *bashkitë* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha